



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Vlorë, më _____._____.2026

KRITERET EKONOMIKE TË PËRGJITHSME

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

2% te fondit limit

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 30 % e vlerës së fondit limit të objektit që prokurohet**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit të objektit që prokurohet**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe / ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën **ISO 9001:2015 “Mbi Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë” / ose ekuivalent** (të vlefshme në datën e zhvillimit të tenderit), në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një **deklaratë**, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë **shërbimin e transportit** të artikujve objekt prokurimi në adresën e autoritetit kontraktor përfitues.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë mostra të mallit ditën dhe orën e hapjes së tenderit , sepse Autoriteti Kontraktor e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat do të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe do të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Dorëzimi i Kampioneve/ mostrave të bëhet Bashkise Vlorë, të etiketuara me ngjitëse , të vulosur/a, mbi të cilin/at të shënohet: “Mos e hapni me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të kësaj procedure prokurimi ”

-Së bashku me mostrat ofertuesi duhet të japë edhe një shkresë të vulosur dhe firmosur ku të listohen mostrat që ndodhen të paketuara.

Lista e produkteve mbi bazën e së cilës O/E duhet të dorëzojnë mostrat,në ditën dhe orën e caktuar në DST;

Nr	Produkti
1	Album Gr.1
2	Album Gr.2
3	Album Gr.3
4	Album me kafshë
5	Album matematike – parashkollore
6	Album gjuhe (abetare) – parashkollore
7	Forma dhe trupa gjeometrik
8	Lodra formuese me ngjyra lloj lego
9	Birrila
10	Rrathë

11	Topa (gome)
12	Mjetet e transportit të ndryshme
13	Lapsa me ngjyra cilësore
14	Kolora cilësorë
15	Kolora për tabele magnetike

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

NJESIA E PROKURIMIT